

VENDIM
Nr. 136, datë 22.2.2012

**PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE TË SHOQËRIVE “HEC ULËZ-SHKOPET”
SHA DHE “HEC BISTRICA 1 DHE BISTRICA 2” SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr.10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a., “Hec Tiranë Lanabregas” sh.a. dhe “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a., dhe përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a., me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a., dhe “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a., të cilët janë në marrëdhënie pune deri më 31.1.2012, për efekt të privatizimit 100% të aksioneve të zotëruara nga shteti në këto shoqëri, i nënshtrohen procedurave të ristrukturimit nga ana e blerësit strategjik.
 2. Ristrukturimi nga ana e blerësit strategjik do të bëhet konform dispozitave ligjore në fuqi të Kodit të Punës, kontratës kolektive dhe kontratave individuale të punës.
 3. Detyrimet financiare, që do të lindin në zbatim të pikës 2 të këtij vendimi, do të mbulohen nga blerësi strategjik.
 4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, shoqëria “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe shoqëria “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha